



## PROCESVERBAL 9/2023

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9 (nëntë) të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 25.10.2023  
Ora: 10.00

---

### Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyçi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Rrafshi

### Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi i cili i njoftoi me rendin e ditës.

### **REND DITE**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022;**
- 6. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shtator 2023;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet rendi i ditës.**

#### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e rregullt dhe e jashtëzakonshme;**

**Urım Suka** - duke mos dashur ti kthehem asaj që ka ndodhur dy seancat e fundit,kërkesa atëherë ishte për dorëheqjen e Kryesuesit mirëpo ajo si duket nuk ka ndodhë.Ne tani presim që organet përgjegjëse të japin fjalën e vet për zhvillimet që kanë ndodhur në ato dy seanca.Qëndrimet që ne kemi mbajtur dy seancat e fundit janë qëndrime tona politike.Kanë qenë qëndrime për me i ndihmu zhvillimit të seancës ndërsa qëndrimet e 2 tetorit kanë qenë qëndrime që rrjedhimisht lidhen me seancën e 28 shtatorit dhe nuk ka pas asgjë personale ndaj askujt.Ndërkohë,sjellja e Kryesuesit për ne ka qenë e çuditshme dhe e papranueshme dhe për shkak të asaj kemi ardhë në atë situatë.Nuk po figuron edhe në procesverbal një pjesë e diskutimit të Kryesuesit që lidhet drejtëpërdrejtë me mënyrën se si i qaset asambleistëve .Për mua është e pa pranueshme ajo që ka ndodh pas daljes sonë dhe mënyrën se si u sjell kryesuesi.Uroj që një situatë e tillë mos të përsëritet më,asnjë asambleisti.Secili ti kemi qëndrimet që i kemi dhe Kryesuesi të silltet mbi bazën e asaj që e ka kompetencë dhe përgjegjësi duke mos linuar asambleistët.Arsyeja dhe pse e mora fjalën është,jo thjesht për me figuru një diçka që është thënë aty mirëpo si një ide që mos me u përsërit një gjë e tillë.Në fjalimin që asambleisti i LVV-së e bën pasi ne dalim,kërkon që asambleistat të mos linqohen nga Kryesuesi ndërsa Kryesuesi përveq që nuk kërkon falje për atë që bën,ky edhe thotë: e linqoj Urım Sukën publikisht.Kjo nuk figuron në proceverbal dhe unë kërkoj që të figuroj kjo për faktin që të jetë dëshmi për atë që është thënë dhe për faktin që mos t’na përsëritet asnjëherë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Me 30 vota për, miratohet pika 1.**

#### **Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa, tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Laureta Tafaj** - ne si grup parlamentar nuk do ta përkrahim këtë projekt-rregullore për arsye se për këtë projekt-rregullore nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik,nuk kemi ftu që ti japim rekomandimet tona pasi

që edhe ne jemi përfaqësues të t'njëjtit qytetar,të t'njëjtit vend,të Suharekës dhe besoj kemi të drejtë bashkë me juve,bashkë me kolegë tjerë të asamblesë me i dhënë propozimet tona dhe me dal me një vendim të përbashkët,dhe jo veq me pru me e votu.Andaj ju lus,nëse keni mundësi ta shtyejmë në një seancë tjetër dhe të punojmë të gjithë sëbashku.

**Shefket Kolgeci** - në emrin tim por edhe në emër të grupit parlamentar kërkojmë që në këtë projekt rregullorë të eliminohet taksa komunale. Ne e kemi propozu edhe në një mbledhje tjetër por nuk e keni përkrah.Për me përkrah ne këtë projekt-vendim,grupi jonë parlamentar kërkon që taksa komunale të hiqet për biznese.Në shumicën e Komunave nuk e kanë taksën komunale.

**Dardan Berisha** - përveq atyre që thanë kolegët asambleist,ajo që më bëri përshtypje,pashë disa ndryshime nëpër të gjitha drejtoritë dhe më bëri përshtypje kopi paste i rregullores së 2015-tës nga Drejtoria e Arsimit.Asnjë ndryshim!Nuk e di si ka funksionu në atë komision edhe pse ka qenë pjesë e komisionit.Nuk e di a ka shku veq me hargju atje energjinë e kotë dhe me i shfrytëzu rrezet e diellit në Durrës.Të gjitha drejtoritë kanë ndryshime brenda strukturës përveq DKA-së që nuk e ka asnjë ndryshim më të vogël.

**Labinot Halitjaha** - jep sqarime si kryetar i komisionit dhe thotë: te financat ka pas disa kërkesa që kanë qenë në ministri ndërsa këtu në rregulloren 2015 nuk kanë qenë si tarifa dhe kam bërë një kërkesë për një ndryshim të vogël dhe të gjitha drejtoritë tjera e kanë pa të arsyeshme që me i shtu disa tarifa,disa me i ndryshu.Kryetari e ka formu komisionin për tarifa dhe gjoba ku kemi punu një kohë të gjatë.Ka ndryshime të vogla,sidomos te shërbimet ku e kemi pa të arsyeshme që të rritet një përqindje e vogël. Pastaj inflacioni ka ndiku që të ndryshohen disa tarifa dhe taksa.E kemi punu secili drejtor pjesën e vet.Ka qenë në dëgjim publik për dy javë.Ne i kemi kry procedurat tona dhe besoj është më e mira e mundshme.Nëse ka dikush diçka për ndryshime të vogla, ne jemi konsultu,p.sh.që ka mundësi një tarif apo diçka që duhet me u ndryshu me kohën, mundemi me sjell në Asamble dhe vetëm atë tarif me ndryshu dhe me ec përpara.

**Avni Bytyqi** - pjesë e grupit punues kam qenë edhe unë dhe siq tha kryesuesi i komisionit,ne i kemi shterrë të gjitha mundësitë ligjore dhe procedurat ligjore.Kemi pas takime të vazhdueshme me drejtorët e drejtorive dhe njerëz që kanë pas interesim që të japin kontribut rreth kësaj projekt-rregullore dhe në fund kemi ardhë në pëfundim që projekt-rreguloren ta hedhim në konsultim publik ashtu siq e kërkon udhëzimi administrativ.Projekt-rregullorja ka qenë në diskutim publik për dy javë por siq e dime te ne,në Komunën tonë nuk ndodh që të japin komente,sugjerime dhe rekomandime nga askush.Pasi janë shterr mundësitë e konsultimit publik,ne kemi ardhë në pëfundim që këtë projekt-rregullore ta dërgojmë në KPF dhe KK dhe tek vje në Asamble që ta merr vendimin përfundimtar për miratim dhe aprovim të mëtutjeshëm në nivelin qëndror.

**Laureta Tafaj** - Po thua që keni mbajtur diskutim publik. Ku është mbajtur?Sa persona kanë qenë aty?A ka dhënë dikush rekomandim? E nëse ne nuk jemi kanë,a është aq mund i madh me na u bërë një ftesë si kuvendar të këtij vendi,mjë thirrje në telefon kur bëhen gjithë ato shopenzime telefonike në këtë komunë!Nuk jeni në gjendje një telefonatë me bo dhe me na thirr siq ka qenë kjo e rëndësishme.

**Avni Bytyqi** - thirrja publike ka qenë për të gjithë qytetarët pa dallim dhe për grupet e interesit.Deri më tani nuk e kemi praktiku asnjëherë si Komunë që të thërrasim njerëz të caktuar që t'japin kontribut në këtë çështje për deri sa thirrja publike është në interes për të gjithë qytetarët .Sa i përket se a ka dhënë dikush vërejtje apo sugjerim,nuk kanë dhënë.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Laureta Tafaj** - ku ka qenë vendi i caktuar për me mbajtur dëgjime publike?

**Avni Bytyqi** - thirrja publike ka qenë dy javë e hapur.Nuk ka qenë takim se ku por kanë qenë të informuar se ku mund ti japin rekomandimet dhe sugjerimet dhe ku mund ta nxjerrin rregulloren.

**Laureta Tafaj** - nuk mundet kërkush me ardhë kur nuk e ke caktu një vend ku don me mbajtur një dëgjim publik.Kjo është vetëm sa për sy e faqe.

**Selman Kolgeci** - fakti që shumica e grupeve parlamentare kanë dhënë vërejtje për këtë projekt-rregullore,tregon çartë që kjo projekt-rregullore duhet me iu nënshtrë ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme dhe me u përfshi të gjitha grupet parlamentare në hartimin e kësaj rregullore sepse kjo projekt-rregullore në thelbin e saj nuk ka për qëllim një strukturim të mirë të taksave,tarifave dhe gjobave por një zhatje ndaj bizneseve dhe ndaj qytetarëve.Deri më tani jemi dëshmitar që shumë biznese janë shpërngul me adresë nga Suhareka dhe janë regjistru në Prizren,Prishtinë e shumë vende tjera.E tëra kjo si pasojë e procedurave të panevojshme,taksave dhe tarifave.Sipas informatave që kamë,ju këtë rregullore e keni hartu pa e ftu,pa e njoftu,e pa e inkuadru qendrën e biznesit.Po hartoni rregullore që më së shumti preken bizneset dhe ju nuk e keni marrë asnjë rekomandim,asnjë këshillë dhe nuk e ke njoftu qendrën e biznesit.

**Alban Berisha** - u përmend këtu që keni bërë ftesë publike por nuk keni marrë pjesë në dëgjime publike . Akti final për miratim është në dorën tonë.Më vjen keq sepse është hera e dhjetë që e potencoj të njejtën gjë.Ne e miratojmë.Në fund thuhet Asamblea komunale e miraton këtë rregullore kurse ne jemi vetëm për me qu dorën ,po ose kundra.Parashihet edhe me ligj që duhet të bëhet edhe një grup punues dhe ekzekutivi konsiderohet si sponsorizues i këtij akti normative dhe ne e miratojmë.Çdo herë kam kërku që te ne mos me ardhë forma para finales si projekt-vendim por me ardhë si draft-vendim.Nuk besoj që është diçka urgjente që me u miratu,çdo akt me ardhë si projekt-vendim kur mund të ketë kohë dhe një rreth seancë me ardhë si draft dhe seancën tjetër me ardhë si projekt-vendim, që ne ta japim kontributin tonë.Kur nuk i keni pas votat,kanë ardhë sugjerimet tona dhe jemi konsultu shpesh dhe jmi marrë vesh edhe për disa pika.Tash,prej momentit që i keni votat,të humb motivacioni edhe me dhënë propozimin. Kjo nuk është e mirë as për demokracinë,as për aktin që kemi me miratu ne në fund sepse kur ta merr formën finale akti, nuk shkruan me kaq vota pro ose kundra por thotë:Asamblea komunale në të cilën marrim pjesë edhe ne si opozitë.Te dëgjimet publike është e vërtetë që çdo kush mund të kontribuoj por grupi punues është i obliguar që palët e interesit ti ftoj.Nëse po doni me nxjerr një akt të mirë,funksional dhe që i shërben të mirës,duhet gjithëqysh gjatë procedurave të hartimit ti ftoni palët e interesit.Besoj në atë që tha Selmani,që qendrën për biznes duhet me ftu sepse dihet që bizneset janë ata që e mbushin arkën e buxhetit.Kryesues,pse nuk vje njëherë draft te ne dhe të thoni:hajde të konsultohemi bashkë dhe të shohim se cilat pika mundën me u ndryshu.Një qytetar vje e jep një propozim dhe ju thotë që jeni shumë të interesun me ndërru por unë ju garantoj, që ne, shumë pika i kemi propozu si asambleist dhe ju as nuk i keni marrë parasysh.Aktet që vin për miratim në Asamble,ju kisha lut që të jeni më të kujdesshëm dhe me qenë ma të gjeneralizune dhe me i nxjerr të gjithë sëbashku.

**Bulëza Kuçi** - pikërisht nga ju kam dëgju,që për të fillu me u ndryshu një rregullore,atëherë duhet të paraqitet nevoja që 30% me u ndryshu ajo rregullore.Pikërisht nga Avniu e kam dëgju këtë.Ndërsa drejtori po thotë që ka pas shumë pak ndryshime.Nganjëherë po mendoj që qëllimi juaj është,me këto pak ndryshime vetëm me i ndryshu rregulloret që në fund të rregulloreve me shënu:Kryesuesi i Kuvendit Bexhet Kuçi.

**Kushtrim Kuçi** - në momentin që e keni bërë njoftimin publik dhe për dy javë nuk ka pas interesim nga qytetarët,a është dasht me ndryshu formën?E përmendi edhe Selmani që herave tjera me u taku me qendrën e biznesit,me u taku me grupet parlamentare,që me bo diçka dhe me gjet zgjidhje.Me pa si rekomandim,që herave tjera me u taku me grupet e interesit dhe me na sjell një plan si i ka hije,që është në interes të qytetarëve.

**Reshat Selimaj** - desha të kyqem te Albani.Ndoshta është e mirë ajo që po thotë por ne jemi disa këtu që kemi qeveris bashkë me juve.Sa herë ju na keni konsultu neve për këto që po i thua këtu?Politikë është lehtë me bo por realiteti është ky.

**Shefket Kolgeci** - Reshat,ti që po thua,ajo nuk qëndron.Gjithmonë kur kemi qenë ne në pushtet,Sali Asllanaj i ka thirrë grupet parlamentare,e ka harmonizu edhe buxhetin dhe ka kalu buxheti pa probleme.Ndërsa ju asnjëherë nuk i keni thirrë grupet parlamentare dhe as nuk na keni konsultu neve. Edhe në këtë projekt-rregullore,po të kishin qenë nga një grup parlamentar i çdo partie opozitare dhe me hartu atë plan atje,unë besoj që këto diskutime sot nuk kishin me qenë asnjë sepse ishin diskutu atje.Mirëpo mos gadishmëria e opozitës pasi që i ka numrat,pse me na konsultu neve.

**Reshat Selimaj** - Dr.Shefket,njëri këtu s'jemi duke e thënë realitetin.Unë po them,që 10 vite që jam këtu,kurrë nuk më ke ftu ti si pushtet kur ke qeveris.

**Laureta Tafaj** - i nderuar Kryetar Muharremaj,ju së bashku me grupin e juaj parlamentar kur keni ardhë në pushtet,a keni thënë që ne kemi me punu më mirë se Kryetari paraprak që ka qenë?Apo keni ardhë në pushtet me thënë:ai nuk e ka bo,s'ka me bo edhe unë.Sepse në çdo seancë unë e dëgjoj nga asambleist të grupit parlamentar të AAK-së duke thënë:nuk e ka bo LDK-ja ,s'kemi me bo edhe ne,nuk na keni ftu ju,s'kena me ju ftu edhe ne.Dikush duhet me ndryshu këtë vend Kryetar.

**Urim Suka** - projekt-rregullorja për të cilën po flasim është një dokument mjaft i rëndësishëm për Komunën tonë i cili ka me vlej të për disa vite ndoshta.Në KPF e kërkova pak a shumë atë që e kërkoi Laureta dhe sidomos Albani ku ky dokument në një seancë të na vie si dreft ku ne të kemi hapësirë me i dhënë mendimet tona me idenë që kur ta miratojmë këtë projekt-rregullore me qenë rregullorja më e mirë e mundshme.Pse ka ardhë nevoja për me ndryshu?Ju e dini,me ato borgje se sa fiskultura u bë për shkak se një rregullore nuk ka qenë e mirë.Nëse ne e miratojmë këtë rregullore me shpejtësi,ideja është që prap kemi me pas probleme dhe kemi me ardhë në një situatë ku prap kemi me bo ndryshime.Kërkesa jonë njëherë është për me diskutu,për me pas hapësirë dhe me i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona sepse e tha

edhe Albani shumë mirë,që ne si kuvend kemi me miratu këtë rregullore dhe jo ju që e keni përgadit.Kjo është për qytetarët.Ndërsa kërkesa që dr.Shefketi e bëri,është kërkesë që ne kërkojmë,që taksa për biznese me qenë zero,me ia lehtësu bizneseve.Ju lus që ta procedoni kërkesën e dr.Shefketit për pjesën tjetër të vazhdimit të kësaj seance.Çështja këtu është,për vullnetin për me bo një rregullore më të mirë.Nëse ju s'po doni këtë vullnet me shtri përpara për me bo një rregullore më të mirë,është në vullnetin tuaj me vepru si të doni sepse ju i keni numrat dhe ne e dime këtë.

**Aziz Bytyqi** - u diskutu gjërsisht çështja e rregullores.Kryetari i komisionit e dha sqarimin e vet,gjë që unë i përgëzoj për punën sepse këtu kemi një ndryshim të pjesërishtëm të rregullores.Diskutime u bënë por nuk patëm ndonjë kërkesë konkrete dhe kjo nuk është kuran që nuk ndryshohet.Nëse do të ketë kërkesa,në të ardhmen mund të vijë në formë të plotësim-ndryshimit.Natyrisht,është detyrë e ekzekutivit me bo rregullore.Ekzekutivi e sjell rregulloren,e arsyeton,e argumenton dhe në fund ne mbajmë qëndrimin tonë me votë.Kjo është detyra jonë.

**Flamur Bytyçi** - po e shoh që në këtë listë prap i keni lënë lojrat e fatit dhe bastoret.Pse nuk i keni përmirësuar këto?Ne i kemi ngrit si çështje herën e kaluar,apo po doni prap me inicu naj çështje për me i hap lojërat e fatit.

**Labinot Halitjaha** - ne e kemi lënë si tarif sepse mund të ndryshoj një ligj nalt dhe me ardhë,pastaj ne shpejt duhet me e ndryshu rregulloren.

**Alban Berisha** - koleg Aziz,është e vërtetë që s'patëm një propozim konkret dhe është shumë shqetësuese pse nuk patëm ne propozim sepse deri tash vetëm kritikuaam dhe nuk patëm një vërejtje substanciale dhe pajtohem me Azizin komplet dhe nuk pajtohem me komplet opozitën pse nuk e patëm një propozim konkret në pikën e caktuar.

**Kryesuesi** - ju si LDK e patët.

**Alban Berisha** - e pat doktorri për taksën komunale por ne shumica nuk patëm.Shqetësuese është pse nuk patëm.Në këtë rast duhet me u shqetësu edhe ju.Kur pe them këtë që ndoshta u bë retorik, kur po them që po e bini projekt-vendim dhe s'po e bini draft,besoni që të humb motivacioni,në situata të caktune të shtin me dhanë propozim se ajo e të banit politikë këtu nganjëherë bëhet retorikë.Unë duke propozu,ti nganjëherë në situata të caktune .Dhe këtë e them me kompetencë të plotë,prej anash qite në votim dhe real i bie që unë foli krejt kot.Përmende një rast prej opozitës kur ka shku një propozim në këtë mandat.Kjo ka qenë njëra prej vërejtjeve që ia kam thënë Kryetarit ku i kam thënë: të lutem Kryetar,vetëm te arroganca e votave ruju sepse kjo është e rrezikshme për demokracinë.E kam thënë në fillim dhe e them prapë dhe gjithmonë ka me thanë.Edhe nëse fiton partia ime në të ardhmen,unë prap do ta them.Kështu që,koleg Aziz,propozime konkrete për vete nuk kam sepse më ka humb motivi edhe pse jam i obliguar ligjërisht me dhënë propozime konkrete.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**Shefket Kolgeci** -propozimi jonë është për eliminimin e taksës komunale.Para se me hedh në votim,ne duhet ta dimë se a pranohet propozimi jonë apo nuk pranohet.Ne duhet ta dime,që nëse pranohet dhe vendoset në procesverbal me propozimin e dr.Shefket Kolgecit,ne e shohim a e votojmë apo nuk e votojmë.

**Kryesuesi** - faktikisht unë do ta fus të parën që e kemi sjell te ju e pastaj nëse kalon e fusim edhe propozimin.

**Urim Suka** - kërkoj interpretim nga zyrtari ligjor. A duhet një herë propozimi me u marrë parasysh apo komplet rregullorja ?Unë mendoj që për procedurë,së pari duhet propozimi të hedhet në votim e pastaj rregullorja se përndryshe nuk ka kuptim.

**Shefket Kolgeci** - ne po kërkojmë që të hiqet taksa komunale e bizneseve në aktivitet.Nëse ju e inkorporoni kërkesën tonë,ne do ta votojmë dhe nëse ju nuk e inkorporoni,ne nuk do ta votojmë.Së pari kërkoj që propozimi të del në votim dhe nëse nuk i marrim votat,ju vazhdoni me shumicën e votave tuaja.

**Dardan Berisha** - desha t'ja bëj një pyetje Urimit.A e keni vizitu ju shoqatën e bizneseve që keni ardhë me këtë kërkesë?Realisht,dy javë përpara,shëfi i gr. parlamentar të LDK-së ose një partie tjetër e ka materialin dhe kjo nuk është e drejtë dhe me ardhë tash në seancë sepse kësaj i thojnë lloj politike me bo. E ke pas kohën dhe ke mujt me shkrim me ia dorëzu Kryesuesit kërkesën ose kujdo.Desha me pas parasysh për ata asambleista që janë për herë të parë në Asamble.Kjo është politikë.Opozita e ka për obligim me bo zhurmë të pa nevojshme dhe ne e kemi obligim me i shtyp senet dhe me punu në këtë drejtim.

**Selman Kolgeci** - Dardani po pyet dhe po sillet si një mësues këtu.Të gjithë jemi të barabartë pavarësisht sa mandate i kemi.Së pari duhet të kërkojmë falje për këtë që po na ofendon.

**Dardan Berisha** - nuk ofendova.

**Selman Kolgeci** - Po ta sqaroj që jam taku me bordin e drejtorëve të qendrës së biznesit dhe pikërisht shqetësimi i tyre është i adresuar këtu. Ti po thua se pse nuk i keni adresu me email. Tash po e adresojmë. Pse s'po e merr parasysh Kryesuesi?

**Dardan Berisha** - nuk është momenti i duhur.

**Selman Kolgeci** - është bash momenti i duhur. Mos u sill si mësues këtu.

**Urim Suka** - e para, duke e përkrah atë që tha Selmani dhe e dyta, ky propozim i LDK-së është në planin qeverisës kur e kemi bërë atëherë. Në një seancë ne e kemi pas pikë të veçantë ku ju e keni refuzuar. Tash ka ardhë kjo rregullore dhe po e japim si propozim. Nuk e di pse po e shqetëson dikënd ky propozim. Nëse ne jemi duke bërë politikë, bëni edhe ju, propozime, kalone dhe le t'ju bje mirë bizneseve. Këtu ka plot biznese të vogla që kjo taksë nëse zerohet është kështu një lehtësim për ta.

**Laureta Tafaj** - Dardan, të gjithë këtu kemi ardhë me vota të qytetarëve. Asnjë nuk kemi ardhë me bërë zhurmë të paarsyeshme. Tërhiqe atë fjalë sepse është shumë ofenduese. Nëse ne jemi duke bërë zhurmë të paarsyeshme atëherë koalicioni juaj është duke bërë zhvatje të paarsyeshme ndaj qytetarëve.

**Dardan Berisha** - unë para se me fol matra tri herë. Unë nuk e tërheki fjalën aspak. Unë nuk e ofendova askënd. Ku e gjen ti ofendimin në këtë mes? Unë thashë që kjo është lloj politike. Urimi po thotë: e kemi pas në plan qeverisës. Mbaje në xhep planin qeverisës. Ke kohë në 2025-tën prap me shpalos në programin tënd.

**Shefket Kolgeci** - Dardani tha që nuk është momenti këtu. Unë mendoj që momenti më i duhur është Asambleja për me u diskutu çdo gjë dhe në fund vendos shumica. Unë e kam thënë dhe e them, që shumë herë shumica e ka gabim por jemi demokraci.

**Avni Bytyqi** - u ngrit një çështje të cilën edhe ne si grup punues e kemi analizuar, çështjen e largimit të taksës në aktivitet mirëpo ne e kemi një bazë ligjore me të cilën e kemi parapa këtë taksë në aktivitet. Është Ligji për financat e pushtetit lokal, konkretisht që i parasheh çështjet e taksës në aktivitet edhe për bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarinë edhe në kuadër të Komunës. Që nga viti 2010, të gjitha këto taksa në aktivitet që i kanë pagu bizneset në raport me Komunën, Komuna çdo herë i ka kthyer në shërbim të bizneseve duke ia rregulluar infrastrukturën rrugore para objekteve të tyre apo edhe çështjet e asfaltimit, kanalizimit, rrymës. Mirëpo ne e kemi analizuar këtë çështje dhe buxheti që është planifikuar për vitin 2024 është planifikuar mbi bazën e shërbimeve që kanë për të kryer bizneset në raport me Komunën. Megjithatë është në dorën tuaj. Sa i përket propozimit të grupit parlamentar të LDK-së, fatkeqësisht deri më sot nga qytetarët asnjëherë nuk na vin propozimet sepse edhe ne si grup punues do të kishim analizuar dhe diskutuar propozimet e qytetarëve. Më çudit fakti se askush nuk bisedoi që me i liru qytetarët të cilët kanë me pagu në raport me këtë rregullore por të gjithë u kapën për biznese. Së pari duhet të shkoj propozimi i LDK-së si propozim se a do të hyj apo jo, e pastaj vazhdon komplet rregullorja në tërësi që të miratohet.

**Selman Kolgeci** - po thotë që nuk e pat askush dertin e qytetarëve. Thashë, që kjo projekt-rregullore në thelbin e saj nuk e ka për qëllim strukturimin e mirë të taksave dhe tarifave por e ka për qëllim zhvatjen ndaj bizneseve dhe qytetarëve.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e grupit të LDK-së.

**13 për, 18 kundër  
Nuk kalon propozimi**

**Kryesuesi** - e hedh në votim Pikën 2.

**19 për, 12 kundër  
Miratohet pika 2**

**Urim Suka** - Kryesues, të kisha lut të mos i përsërisim dy seancat e fundit. Mënyra se si u drejtova ku the: qu Urim numëroi, është e papranueshme. Mos ma jep rastin edhe ti, me bo unë politikën time.

**Kryesuesi** - nuk po sillem në atë formë por ti po e kërkon. Është hera e katër që ti më drejtoheshe me këto sulme ndaj meje.

**Urim Suka** - në rastin që po flasim është mirë të sillemi pak ma seriozisht. Me që ti po ngrit shqetësim se a me i numëro unë apo ti, unë të propozoj që ta cektosh një numërues tjetër i cili i numëron dhe ta bjen rezultatin aty, për seancat e ardhshme e kam fjalën.

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - përveq datës kjo rregullore nuk ka ndryshu kurgja hiq prej dy seancave të kalume. Me u rrit çmimi për mbi 30% pa u rrit pagat e punëtorëve për 30%,mua po më duket kjo rritje shumë e paarsyeshme.Nuk e di se pse e bini çdo dy muaj këtë rregullore kur asambleistat po e votojnë për mos me u shtrenjtu çmimi i mbeturinave.Nuk e di se çka ka këtu për me ia mbush menën dikujt për me votu prej kundër në pro pa ndryshu kurgja hiq.Shpresoj që kjo pikë mos me u votu sepse përndryshe do të ishte një mashtrim i radhës për kolegët asambleistë të pozitës,njësoj si ka ndodh edhe te buxheti,se kërkesat e tyre nuk janë implementu e nuk kanë me u implement.

**Urim Suka** - debati për rregulloren për të cilën po flasim tashmë veq është i shterrur sepse është hera e tretë që kjo rregullore na vjen neve për votim.Për mua dhe për grupin tonë është e çuditshme dhe e papranueshme dhe nuk pe kuptoj.Dua interpretim ligjor edhe të juristit se deri kur mund të na vijë kjo rregullore.Një pushtet që është pak serioz duhet me i thirrë grupet parlamentare nëse asambleistat një projekt-rregullore i thonë jo.Duhet me i thirr në takim përfaqësuesit e partive politike dhe me ia shpjegu që kjo rregullore është e mirë.Të kërkojnë naj propozim dhe ta miratojmë bashkë sepse nëse keni naj arsyetim të bazun e që është i mirë,nashta e përkrahim.Deri tash arsyetimet që i keni dhënë,keni thënë që s'është kompetencë e juaja.Keni thënë:pagat e punëtorëve por ju s'muni me i rrit pagat e punëtorëve.Keni thënë: çmimi i naftës por çmimi i naftës është ulë pak.Është mirë ta kthejmë pak në seriozitet përndryshe në një formë ne jemi duke u shantazhu sepse vje qe tri herë.Ne si LDK e kemi dhënë një rrugëdalje në këtë drejtim.Ne jemi për me votu këtë rregullore dhe propozimi jonë ka qenë konkret.Krejt rregulloren e mbështesim vetëm çmimi për njësitë familjare me qenë si ka qenë deri tash 4.50€.Pjesa e biznesit më lehtë e përballojnë dhe krijohen disa të hyra te kompania nëse ka vështirësi për shkak të rritjes së çmimeve.Në anën tjetër,nëse kjo kompani prap vazhdon me pas probleme,hajde pjesën tjetër ta mbulojmë me buxhetin e Komunës,me kontratën që e kemi vazhdimisht me Eko regjionin.Hajde e marrim propozimin tonë dhe sot e votojmë rregulloren.

**Kushtrim Kuçi** – Kryetar,unë i kam bërë kërkesë zyrës që gjendet në Komunë për biznese dhe kam pyet se sa biznese tarifohen me taksë dhe numri i tyre ka qenë dikun 3075 biznese.Të njëjtën pyetje ia kam bërë edhe zyrës e cila merret me mbledhjen e mbeturinave dhe ata kanë deklaruar që numri i bizneseve që pranojnë shërbime të mbeturinave është 910.Të njëjtën kohë ma kanë dërgu edhe numrin e bizneseve aktiv në Komunë sipas zyrës së tyre,që është 2886 mirëpo ne duhet me iu referu zyrës së bizneseve në Suharekë.Këtu,dallimi është 3075 biznese,pa i llogaritur 200 biznese që janë formu dy muajt e fundit.Dallimi është 1165 biznese të cilat janë taksapagues në Komunën e Suharekës por nuk paguajnë mbeturina.Dallimi është 2165 biznese mirëpo unë e kam marrë parasysh që nuk ka shanca këto 2165 biznese m'i gjetë sepse shumica mund të jenë edhe shtëpi private që e kanë deklaruar biznesin mirëpo nuk dihet lokacioni.Unë i kam largu 665 biznese që nuk mundemi mi gjet dhe e kam bërë 1500 biznese.Sipas parallogaritjes që e bëra,e kam marrë çmimin mesatar prej 9 €.1500 biznese nga 9€ në muaj po i bje 13500€ për një muaj dhe për 12 muaj i bie 162.000€.Me 162.000€ është në gjendje ky institucion me mbajtë veten pa kurrëfarë problem.A është keqmenaxhim?A nuk po munden me menaxhu në mënyrën ma të mirë të mundshme?sepse pastaj po lindin dyshimet edhe te shtëpitë private, sepse besoj që dukshëm është numri më i madh se sa e kanë paraqit këtu.Nëse e kish bo menaxhimin si duhet,duke llogaritë numrin e bizneseve që i kanë lënë anash,shtëpitë që secilën herë po rriten,atëherë besoj që nuk do t'kish pasë problem që kjo kompani me u vetfinancu dhe me i ble ato makineri me forca vetanake,që mos me qenë barrë për Komunën.Është mirë të hulumtohet në këtë drejtim dhe me gjet një zgjidhje.

**Flamur Bytyçi** - nëse nuk gaboj,e kam pa një njoftim të Kryetarit ose të Komunës që do të themelohet një ndërmarrje.Pse po ngutemi ne tash me i rrit çmimet kur po presim të themelohet ndërmarrja?Pse kemi nevojë ne me ngrit një çmim ku paret shkojnë dikun që ne s'kemi ndikim për me i rrit pagat?

**Kryesuesi** - sa i përket ndërmarrjes diçka ka lëviz në atë drejtim por është një ndërmarrje publike që ka me u marrë me diçka tjetër,jo me mbeturina.

**Flamur Bytyçi** - aksionet nga atje,13%.Nëse mundet dikush të na jep sqarime.

**Kryesuesi** - jo,nuk besoj.Nëse shkojmë në këtë trend të rritjes të aseteve në atë ndërmarrje,ne duhet të kërkojmë me i rrit aksionet e përqindjes.

**Kryetari** - deri sa nuk e kemi kriju një ndërmarrje nuk kisha pas dëshirë të flas.Ajo ndërmarrje ka me qenë komunale dhe në radhë të parë ka me u formu bordi dhe bordi ka me zgjedh drejtorin.Duhet të

gjendet lokacioni,të përcaktohet buxheti.Sa i përket Eko Regjionit,është ndërmarrje regjionale dhe kemi aksione 13%.Të gjitha donacionet që janë marrë 5 vitet e fundit, janë regjistru asete të Komunës me vlerë 1 milion euro. Mbi 50% e punëtorëve e kanë lëshu punën për shkak të pagave.Ne nuk mund të marrim përgjegjësi si Kryetar dhe si institucion i Komunës që i ngritim pagat por për këtë vendim e kemi pas një presion prej Gjajkës edhe pse na ka përkrah Gjajka japoneze.Këtë vendim e kanë marrë edhe Komunitat që bëjnë pjesë në regjionin e Prizrenit.Unë ju kuptoj juve,që po thotë:sa firma janë,por ne nuk jemi institucion që dalim me i mbledhë taksat e mbeturinave por e ka kompania.Nuk është e lehtë me ardhë sot dhe me marrë bërlllogun në Gjinoc për 1€ 15 cent në javë.Duhet ta kuptojmë që sasia e mbeturinave është rrit.Nëse e kanë rrit edhe Komunitat tjera,duhet të paktën me bo analiza dhe me i stimulu ata punëtorë sepse e kanë punën më të zorshme dhe më të ndytë.Që tha Urimi,ne e kemi marrëveshjen dhe i paguajmë. Ne mund edhe ta rrisim marrëveshjen.Mirëpo unë po them,që në fillim të vitit,kanë me e caktu një bord me partitë politike por ajo kompani është tjetër gjë.Por në të ardhmen nuk është e thënë që ne nuk kërkojmë që aksionet tona me i bartë çdo herë duke iu referu ligjit dhe në qoftëse kemi të drejtë atëherë e marrim edhe në mbikqyrje.Kryetari tutje jep sqarime.

**Laureta Tafaj** - nëse jo një dokument që paga e punëtorëve ka me u rrit,të paktën një afat kohor Kryetar që munesh me na thënë, që mbas dy-tre muajve ne kemi me rrit pagën e punëtorëve,atëherë ne kemi me votu.

**Kryetari** - në qoftë se i rritet Rahovecit,Dragashit dhe Malishevës,edhe Prizrenit dhe Suharekës ka me iu rrit paga.Ajo është një kompani regjionale dhe nuk ka mundësi me marrë vendime,për Rahovec ndryshe,për Dragash ndryshe dhe për Prizren ndryshe.

**Dardan Berisha** – Kryetar,ti iu referove rregullores.I përmende punëtorët,rrugën Reçan-Bukosh dhe brenda kësaj rregullore kërkon nuk shkruan rritja e pagës për punëtorë.Është vetëm rritje e tarifës e cila e ngarkon vetëm qytetarin.Në këtë rast ne e kemi një komision që ka dal prej ktij kuvendi dhe nuk e di kush është në komision dhe realisht ne si Kuvend jemi të pa informuar në lidhje me mënyrën e menaxhimit të Eko Regjionit.Ose kanë mbajtë takime ose nuk kanë mbajtë asambleistat që janë të delegun prej neve sepse asnjëherë nuk na kanë raportu për punën dhe angazhimin e komplet Eko Regjionit.

**Kryetari** - ndërmarrja komunale është aprovu nga Qeveria e Republikës së Kosovës por ka procedura në aspektin ligjor.Në kompaninë regjionale e kemi vetëm një anëtar,s’kemi ekzekutiv.Ne e kemi edhe kompaninë regjionale siq është Hidro regjioni.Ne e shtojmë sasinë e ujit por ata përgjegjësitë dhe as llogaritë nuk na japin neve.Ju lutem mos ta përzieni ndërmarrjen regjionale të pastrimit me ndërmarrjen komunale.

**Dardan Berisha** -këtu na ka ardhë një rregullore për tarifa dhe ne duhet me diskutu rregulloren për tarifa. Se çka bën ai në Malishevë e Rahovec është çështje tjetër.Në këtë rast,nëse po përmendet regjioni,le ti rrit pagat eko regjioni në Prizren për gjithë punëtorët edhe të Malishevës,Rahovecit,Suharekës,edhe ne jemi pro pajtimit por nuk mund të dalim jasht kornizave sepse ne po flasim diçka tjetër e ti po thua diçka tjetër.

**Kryetari** - nuk mund të flas për paga.Me pas qenë kompetencë e jona,deri tash i kishim rregullu.Të gjitha Komunitat që bëjnë pjesë në regjionin e Prizrenit i kanë aprovu këto kërkesa.Kjo është kërkesë e gjajkës.

**Urim Suka** - ne nuk jemi tu përzi kurgja.Me fjalimin që e mbajti Kryetari,e përziti krejt.Jemi duke diskutu qe tri herë për një rregullore dhe unë kërkoja të di, deri sa herë është e ligjshme të na vijë kjo sepse në një formë kjo është presionpër ne.Kërkoja por nuk mora përgjigje.Ne e kemi propozimin konkret dhe sot e votojmë rregulloren.Çmimet për njesi familjare të mbesin 4.50 me që Kryetari tha që e shtojmë buxhetin atje.Propozimi jonë le të kalojë,kalon rregullorja komplet.Sepse është në interes të qytetarëve dhe jo pse është propozimi jonë.Dy herë i kemi thënë jo kësaj dhe dua interpretim,se sa herë duhet me ardhë kjo,a ka një kufi?

**Selman Kolgeci** - është hera e tretë që po vje kjo rregullore dhe dua ti kallzoi Dardanit që kjo është ajo zhurma e panevojshme.Kryetari po thotë që e kanë marrë vendimin regjioni.Po Kryetar,vendimin regjioni e kanë marrë,edhe taksë 0 në biznese.Pse nuk ia ke hek bizneseve ?sepse e patëm pikën paraprake.Po thua i kanë pagat.Edhe unë jam për me ia ngrit pagat.Kush është garantues që nëse rritet çmimi, kanë me iu rrit pagat?E përmende edhe kanalizimin.Te kanalizimi i ke hargju gati 1 milion euro në sanim por i ke hargju dhe nuk ke bërë sanim.Mos u lidh te temat e kanalizimit,se kemi makineri,s’kemi makineri.Mund ta vendosesh te kriteret për kompanitë që kanë me apliku për sanimin e kanalizimeve,atë mekineri që ti po e kërkon.

**Kryetari** - aty ku inkasohet uji është një taksë ku për çdo muaj paguani taksën për kanalizim.

**Selman Kolgeci** - akoma më keq që paguhet taksa për kanalizim dhe ti shpenzon mjetet të qytetarëve për sanim kanalizimi.Ku je tu i qu këto pare?



**Kryetari** - lypi.

**Selman Kolgeci** - ti kam lyp edhe me email, edhe me shkresa zyrtare dhe nuk je përgjigj. Për atë e ke marrë edhe një vendim dhe ke me marrë një penallti shumë shpejt prej agjensisë për informim dhe privatësi.

**Kryetari** - jam i hapur 24 orë ndaj të gjitha organeve të drejtësisë, hetuesisë, prokurorisë. Krejt çka doni, keni me i marrë në mënyrë publike dokumentet. E kemi obligim, çdo qytetari që kërkon me ia dhënë. Bashkëpunojmë pa problem. Edhe ato dy që thua ti, i kanë marrë, i kanë kthyer.

**Selman Kolgeci** - përgjigjen e du qysh e kam kërku, në email. Në email kthemi dokumentet dhe jo me ardhë këtu dhe me thanë: unë jam i hapur dhe të kemi leju qasje. Ku më keni leju qasje? Ja ku i kemi korrespondencat në email. Ti nuk lejon qasje.

**Kryetari** - çdo organ e ka përgjegjësinë e vet. Çdo dokument jemi të obligun me ligj, ata që e kërkojnë me iu dhënë qasje.

**Liridon Fandaj** - u thanë shumë për rregulloren. Desha ta pyes Kryetarin, që në këtë rregullore a e diskualifikon naj kompani të licencuar që me konkuru për me i mbledh mbeturinat? Në këtë rregullore sa e kam pa, përveq tarifës që rritet edhe inkasimin ka me bë Kuvendi Komunal. Kuvendi Komunal është i obligun me qit në tender dhe mos me diskualifiku një kompani edhe private. Dhe nëse del në tender nuk mund me përcaktu çmimin, mund ta merr dikush edhe me 3.50€. Kjo rregullore e parasheh veq rritjen e tarifës për qytetarin por nuk parasheh rritje të pagave të punëtorët e Eko regjionit sepse kjo rregullore është e sponsorune prej një organizate siq është gjajka por nuk është prej K. Komunal dhe nuk mund ta diskualifikosh një kompani private nëse nesër konkuron për me marrë menaxhimin e mbeturinave.

**Kryetari** - vetëm e zbatojmë ligjin.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**13 për, 17 kundër  
Nuk miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Alban Berisha** - si qytetar i Suharekës jam i pajtimit me këtë propozim për z. Myfail Gashi. Dua ta uroj artikulesin e dokumentit të propozimit të Kryetarit por më pengoj pse nuk ka pak më shumë biografi për të mirat publike të z. Myfail Gashi sepse z. Gashi nuk është një udhëheqës që e ka zhvillu biznesin e tij por z. Gashi është edhe kontribues në shumë sfera të jetës në Komunën tonë, si në aspektin e kultures, sportit dhe i dimë edhe të mirat infrastrukurore që i kemi gëzu ne si Komunë. Kështu që, kisha pas qef, që për çmimin “Ukë Bytyçi” jo vetëm sivjet por çdo herë kur të ka një propozim, krahas biografisë personale dhe të arriturave dhe udhëheqjes personale të tij, të paraqiten në biografi edhe të mirat publike ose kontributet që i gëzojnë publiku i ngushtë edhe i gjerë i Komunës tone, që me qenë inkurajuese edhe për të ardhmen propozimet tjera. Edhe ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Shefket Kolgeci** - gjithëashtu edhe unë jap dorëheqje të parevokueshme nga ky komision për shkaqe objektive, subjektive dhe personale. Nuk kam marrë pjesë në asnjë mbledhje të këtij komisioni andaj edhe jap dorëheqje të parevokueshme nga ky komision.

**Laureta Tafaj** - arsyetimi i dhënë në këtë dorëheqje nga kolegja Kuçi-Rexhepaj nuk mendoj që është i drejtë për arsye se ne kemi punuar pothuaj një vit në këtë komision në përjashtim të Dr. Shefketit. Ndoshta kolege nuk jena kanë profesionist sa ju por të paktën kemi punu shumë dhe një vit kemi punu në atë komision. Në seancën e fundit të komisionit që kemi pas me mbajtë, kemi pas me marrë vendim, me përpilu dhe me sjell në Asamble. Për një seancë të vetme nuk keni mujt me prit dhe me përfundu atë punë një

vjeqare.Nëse ka qenë aq e lehtë për një vit me u përfundu,pse nuk është përfundu edhe mandatin e kaluar kur ju keni qenë Drejtoreshë e Urbanizmit dhe e keni pas pikërisht të njejtin komision?Nuk e keni përfundu dhe sot vjen dhe na gjykon neve që e kemi tejzgjat punën në komision,atëherë unë mendoj që është e padrejtë.Gjithëashtu edhe unë jap dorëheqje nga ky komision sepse nuk mund të jem e vetmja anëtare e Kuvendit pasi që dy të tjerët që kanë mbet janë ekzekutiv.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - realisht unë arsyetimin e kam dhënë në shkresë ku e kam protokolu dhe e kam dërgu edhe me email.Që nga muaji gusht,unë kam dhënë dorëheqje nga ky komision dhe nuk e di sa takime i keni mbajtë.Lauretë,po ta rikujtoj që plotësim-ndryshimi i vendimit për formimin e këtij komisioni është marrë në muajin shkurt dhe ne jemi taku tek në muajin maj për me fillu punën tonë.Po pajtohem që gjatë muajit maj i kemi mbajtë disa takime dhe e kemi përafu punën por prej muajit maj deri në muajin gusht kur unë kam kërku dorëheqjen,unë kam insistu disa herë të takohemi për me përmbyll punën tonë dhe asnjë reagim nuk ka pas nga ana e kryetarit të komisionit,Visarit.Kam qenë edhe në zyre te ai dhe kam kërku të mbajmë takim tjetër dhe ta përmbyllim sepse kemi pas disa propozime që janë dhënë në këtë komision dhe me e sjell në Kuvend,normalisht nëse ishin pajtu edhe investitorët. Ka pas heshtje,ka pas injorim dhe unë nuk kam dasht me qenë pjesë e këtij komisioni në mënyrë të injoruar.Pse nuk e kemi kry punën atëherë dhe ka ardhë tash?Ne si komision i mandatit të kaluar,komplet punën tonë e kemi përfundu por nuk është pajtu investitori me atë propozim sepse i ka pas disa vendime të cilat edhe vet i ke pa.Kjo lëndë nuk është e lehtë dhe nuk është lëndë që e ka secili mandat qeverisës.Prej mbas lufte besoj që është i dyti rast që Komuna shqyrton një lëndë të tillë.Mendoj që arsyetimi im është me vend dhe puna nuk duhet me u injoru.

**Visar Kuçi** - kur u votu vendimi i parë në Asamble,një anëtare e komisionit ka dhënë dorëheqje.Pastaj ka zgjat procedura edhe dy ose tre muaj deri kur është plotësu anëtari tjetër.Pasi u plotësu anëtari tjetër,unë i kam ftu komisionin dhe takimin e parë kam thënë që të mos jem kryesues i komisionit për shkak se kam angazhime tjera dhe unë e kam propozu Sanien për shkak se ka marrë pjesë edhe në komisionin e kaluar.Kur e kam ftu komisionin,Dr.Shefketi ka thënë që s'vi në këtë komision.Me shkrim nuk ma ka dorëzu.8 takime i kemi edhe në procesverbal që i kemi mbajtë.Përveq 8 takimeve neve na ka lind edhe një problem me investitorin ku ka kërku me ndërru vendimin për pjesën tjetër dhe na ka marrë kohë 3 muaj deri ku është ndërru vendimin.Pasi u ndërru vendimi,ne kemi mbajtë takime tjera dhe kemi ardhë deri në draft të raportit.Qysh tha Laureta,raporti ka mbet veq me u finalizu dhe me ardhë në Asamble.Ta keni parasysh,që të gjithë që po jepni dorëheqje sot është përgjegjësi e jona sepse edhe ne kemi asete të Komunës në atë parcellë dhe duhet me pas përgjegjësi.Sa ma shumë që vonohet ai investim për Komunën është më keq.Më shumë kemi ne investim aty se palët private.Që po jepni dorëheqje ju,edhe neve le të na shkarkon ekzekutivi por e kemi përgjegjësi para investitorëve sepse jemi zotu,e kemi një kontartë,një marrëveshje.Është fakt që ka qenë njëri prej komisioneve më të vështira por e kemi ofru shumë dhe unë mendoj që që është e gabueshme që po largohet komisioni në fund.Njejtë ka vepru edhe komisioni i kaluar.Ne jemi duke i dëmtu edhe investitorët edhe Komunën.Pala është i paisur deri në taks dhe vetëm është duke e prit lejen.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - po thu që çdo vonesë i shkakton dëm Komunës dhe pikërisht për këtë arsye unë kam dhënë dorëheqje.Për shkak se tre muaj nuk ke qenë në gjendje me ftu komisionin përtej insistimit tonë që me u taku.Pse i ke shkakto këto vonesa unë nuk e di.Ti po bie ndesh me fjalën tënde.Zvarritje është për shkak se prej muajit maj deri në shtator nuk e di a jeni taku,veq ftesa më ka ardhë por unë në muajin gusht veq kam kërku dorëheqje dhe nuk ju kam përgjigj n'ftesë.Përtetj asaj,investitori na ka shënu email të gjithëve,përfshirë edhe kryesuesin dhe i vetmi që ka kthy përgjigje është kryesuesi.Ti si kryetar i komisionit,a e ke marrë në shqyrtim atë lëndë?A ke kërku që ne me u taku,me shqyrtu kërkesën e tij dhe me kthy një përgjigje zyrtarisht?A e kemi obligim me i kthy përgjigje zyrtarisht?A i ke kthy përgjigje zyrtarisht?Pse s'na keni njoftu neve si anëtar të komisionit rreth përgjigjes?

**Visar Kuçi** - i kam procesverbalet.Kemi pas takime.Kemi pas takime edhe joformale ku e kemi ftu disa herë edhe investitorin.Kemi pas probleme disa herë me investitorin dhe problemin e din edhe ti ku e kemi pas me investitorin.Prej majit kemi pas takime dhe në gusht.Ti në momentet e fundit ke dhënë dorëheqje.Prej majit kemi pas takim edhe në gusht.Ka dërgu investitori email,ja kam kthy emailin.Kemi mbajtë takimin.Kur e kam ftu takimin e fundit,ti ke thënë: jo sepse unë kam dhënë dorëheqje.Nuk e ke pru dorëheqjen te grupi punues.Ne nuk e kemi dit.Nuk është shkas vonesa e komisionit dhe as injorim s'ka pas.I kemi edhe komunikimet e grupit punues në viber.A e din pse s'ka pas injorim?sepse pala ka ardhë te unë çdo javë dhe e kuptoj palën.Keq që po jep dorëheqje komisioni.Keq për opinionin,keq për investitorët në Komunën tonë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - grupin the që e kemi në viber. Veç mundesh me marrë edhe me lexu. Kam fol vet me veti. Kam shënu tri-katër herë: po takohemi. Ti si kryetar i komisionit asnjëherë nuk ke dhënë përgjigje. Sanie Kuçi Rexhepaj lexon bisedën e fundit në viber, të 11 korrikut dhe thotë që s'ka marrë përgjigje nga askush. Drafti që po e përmend ti ekziston qysh nga mandate i kaluar. Pengesat i dimë krejt dhe vullneti im ka qenë maksimal, edhe mandatin e kaluar edhe këtë mandat me shty këtë proces përpara dhe me përfund. Nuk thashë që nuk kemi mbajtur asnjë takim. Takime kemi mbajtur. Mos i jep kahje tjetër. Prej muajit maj deri në shtator kur ti e ke dërgu ftesën, i ka tre muaj.

**Kryesuesi** - ne jemi duke e diskutu dorëheqjen tënde dhe nuk kemi pse të hymë më thellë te komisioni.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - as nuk desha ta marrë fjalën sa i përket kësaj pike sepse i kam dhënë sqarimet e mia por që mor tjetër kahje.

**Selman Kolgeci** - këtë komision e ka themelua Asambleja dhe ju jeni epror i këtij komisioni, që ta marrë për të madhe ty që nuk ke kërku prej komisionit një raport. Është për të ardhë keq niveli i debatit që po bëjnë këtu. Ju keni qenë në komision dhe unë e shoh të arsyeshme arsyetimin që e ka dhënë Sania për shkak të neglizhencës. Këtë debat që po e bën me drejtorin e urbanizmit është dasht me bë dikun tjetër. Ti derjtor i urbanizmit ka qenë dasht me thirr sepse e ke pas anëtare të komisionit dhe me u sqaru dhe mos me i pru edhe bisedat në viber që i keni si komision.

**Dardan Berisha** - filloi mësuesi.

**Selman Kolgeci** - tu kisha lut, le të jetë hera e fundit që ndërhy.

**Dardan Berisha** - sa herë të du ndërhy.

**Pas një debati në mes të Dardan Berishës dhe Selman Kolgecit, Kryesuesi kërkon 10 minuta pauzë, pas pauzes Kryesuesi konstaton se ka kuorum të mjaftueshëm dhe vazhdon seancën.**

**Kryesuesi** - në bazë të rregullores së punës kur një asambleist flet, të tjerët duhet ta dëgjojmë. Ia tërheki vërejtjen Dardanit për ndërhyrjen që ia ka bë Selman Kolgeci.

**Aziz Bytyqi** - të dashur kolegë po ju lutem sinqerisht dhe shpirtërisht. Jemi njerëz dhe mund të gabojmë por gjithmonë gabimin lejeni si gabim momental sepse jemi njerëz dhe bëhemi nervozë dhe nuk kemi nevojë me i personaliziz çështjet. Kjo çështje të jetë një rast i izolim përgjithmonë dhe të kemi kujdes që gjithësecili nga ne ta respektojmë njeri tjetrin.

**Kryetari** - ju jeni të zgjedhur me votën e popullit dhe kuptohet që ka pozitë dhe opozitë. Kjo është demokraci dhe duhet me pranuar. A më vje mirë apo jo, opozita ka të drejtë me fol. Mos hyni në çështje private. Kërkoj falje sepse kjo nuk është e mirë me ndodh në Komunën e Suharekës.

**Kryesuesi** - të nderuar anëtar të Kuvendit, këto dy seancat e fundit me të vërtetë kemi pas pak një përçarje, ngritje toni dhe po e nisi prej vetvetës sepse kjo që ndodhi më detyron mua me u kthi pak mbrapa. Në qoftëse Urimi e sheh që unë e kam ofenduar, po ju them publikisht që i kërkoj falje. Nuk po kam dëshirë me ndodh këto gjëra me një Komunë që jemi, një Komunë shumë e qetë dhe kemi një unitet së bashku. Këtu jemi në interes të qytetarëve dhe a kalon apo nuk kalon një vendim, ne jemi prap miq.

**Urim Suka** - e përgëzoj Kryesuesin për qëndrimin që mbajti. Ne duhet asnjëherë mos me marrë asnjë temë personale dhe Kryetari në diskutimin e tij tha që pranoj çdo kritikë. Ne jemi në demokraci, jemi duke u përball me fakte dhe argument. Ne si opozitë asnjëherë s'kemi qëllim individin personalisht. Në raste të caktuara mund të dalim prej vetvetës dhe nëse dalim prej vetvetës duhet me pranuar një faj kur e bëjmë dhe duhet me kërku falje. Asnjë qytetar nuk na kavotu për me tregu arrogancë por për me ardhë me fol me argument. Uroj që këto që kanë ndodh seancat e fundit, të jenë raste të izolime, të reflektojmë secili që këto situata mos të na përsëriten asnjëherë.

**Alban Berisha** - Kryesues dua të drejtohem ty së pari si Kryesues. Është e vërtetë që ekziston një rregullore dhe shumë shpesh kemi pas vërejtje, personalisht edhe unë. Fatmirësisht nuk është e përcaktuar me rregullore që nuk guxon kërku me dal jashtë. Ai që s'mun me ndëgju dikënd mund të dalë jashtë para se me ofendu sepse pavarësisht çfarë kualifikimi kemi ne këtu, secili e kemi një intelekt tonin dhe një integritet familjar. Secili përgaditemi për me ardhë në këtë seancë dhe jemi të thirrur, dhe nuk paguhemi pak për pjesmarrje. Nëse unë e përgaditi një temë apo kush do prej opozitës, është ofenduese dhe shumë injoruese me i ndërhy. Neve nuk na ka emru as Kryetari e as ti. Shumica prej nesh kemi me dalë mandatin tjetër prap me kërku vota dhe është një organ krejt tjetër, nuk është një person që na emnon këtu por janë disa qytetarë që na votojnë dhe është diçka tjetër ajo politika se a zgjidhemi, a ri zgjidhemi apo humbin. Shumë shpesh e kam cek që me iu përmbajtur rregullores dhe nuk është hera e parë kjo që ka ndodh. Nuk ka asnjë individ që e ka të drejtën, as ligjore dhe as politike me ndërhy në mua se a kam tepru apo se kam tepru. Nëse gjatë fjalimit tim bëj fyerje jashta rregullores, e jotja është me ma nal fjalën.

**Selman Kolgeci** - po ndërlidhem me situatën që sapo ndodhi. Është e vërtetë që kemi pas debate të ashpra por asnjëherë nuk e kemi prek dinjitetin e as krenarinë e asnjërit prej anëtarëve të Kuvendit, drejtorave, Kryetarit apo kujdo tjetër. Fjala e lire është baza e demokracisë andaj kërkoj falje prej anëtarëve të Kuvendit, ekzekutivit, Kryetarit, Nënkryetares, juve, zyrtarit ligjor. I kërkoj falje edhe qytetarëve e sidomos nënës time, gruas dhe fëmijëve. Shpresoj që mos të ndodh një gjë e tillë. Sa i përket pikës që isha duke e diskutuar, nuk dua të vazhdoj më.

**Kryesuesi** - me qenëse të tre anëtarët e komisionit nga ana e legjislativit kanë dhënë dorëheqje, unë kërkoj prej grupit të LDK-së të propozoj dikë.

**Urim Suka** - ne si LDK nuk kemi propozim për këtë komision.

**Aziz Bytyqi** - edhe ne nuk kemi propozim për këtë komision.

**Laureta Tafaj** - nuk kemi propozim.

**Mevlude Kabashi** - nuk kemi propozim.

**Kryesuesi** - me qenëse nuk ka propozime për këtë komision, kërkoj që ta hedhë në votim shfuqizimin e vendimit në tërësi sepse nuk është funksional.

**Alban Berisha** - është e vërtetë që situata pak na nali për atë çka patëm me thanë dhe është shumë keq. Nuk e di a është e udhës me ndërpre seancën sepse unë personalisht nuk po ndihem mirë me ngjarjen që ka ndodh dhe besoj edhe ju. Me vazhdu një ditë tjetër sepse nuk ka shumë pika tjera dhe normal që ne nuk do duhej me u nal. Nëse po vazhdojmë dhe po shfuqizohet ky vendim, e kisha lut ekzekutivin, Drejtorin Visar dhe Kryetarin që mos të merret si adut kjo që Asambleja ke shumë neglizhente dhe e shfuqizoj një vendim dhe me u ndal kjo punë. Është e stërzgatur dhe burokracia është në maksimum në këtë rast.

**Kryesuesi** - shpresoj që seancën e ardhshme me pru një vendim dhe me formu një komision të ri.

**Jehona Rrafshi** - Kryesues, ti kërkove të gjitha propozimet nga të gjitha subjektet politike por mos harro që këtu ka përfaqësues të partisë Nisma Social Demokrate. Pavarësisht që nuk do të jemi pjesë e këtij komisioni por ta kesh parasysh.

**Urim Suka** - dua ti bashkohem propozimit të Albanit dhe ndoshta mirëkuptimin e të gjithëve që kjo seancë ndoshta ban me vazhdu javën tjetër pas orës një dhe ndoshta mund të formohet edhe komisioni nëse doni me i ngut procedurat.

**Qëndrim Elshani** - unë mendoj që pasi është vetëm edhe një pikë si informatë, ta përfundojmë edhe këtë pikë dhe pikën pyetje dhe përgjigje e lëmë për seancën e radhës.

**Kryesuesi** - e hedh në votim shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12153 të datës 28.02.2022.

### Me 23 vota për shfuqizohet vendimi

**Shefket Kolgeci** - Nëse është mundësia, pikën 6 dhe 7 ti lëmë për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë.

### Pika 6. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shtator 2023;

**Kryesuesi** - hap debatin për pikën 6. Nuk ka debat.

Takimi përfundoi: 12:10

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj